

VENDIM
Nr.15, datë 27.12.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË “RREGULLOREN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR.166, DATË 16.12.2004

Në mbështetje të nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Në nenin 114 të Rregullores së Kuvendit pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Kuvendi shqyrton me debat dhe voton raportin e Komisionit Hetimor në një seancë të veçantë brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij.

Konferenca e Kryetarëve përcakton datën e debatit dhe të votimit në Kuvend të raportit, në të cilin kërkohet shkarkimi i anëtarit të organit kushtetues, si dhe kohën e debatit, sipas nenit 48 të kësaj Rregulloreje.

Në rast se anëtari i organit kushtetues, për të cilin kërkohet shkarkimi, kërkon të dëgjohet në seancë plenare, Kuvendi është i detyruar ta dëgjojë atë.

Raporti i Komisionit Hetimor, që i propozon Kuvendit shkarkimin e anëtarit të organit kushtetues, miratohet nga Kuvendi me shumicën e parashikuar rast pas rasti në Kushtetutë.

Kur raporti për shkarkimin e anëtarit të organit kushtetues nuk merr numrin e kërkuar të votave, ai quhet i rrëzuar.

Për ato raste që parashikohen në Kushtetutë, vendimi i Kuvendit për miratimin e raportit të shkarkimit të anëtarit të organit kushtetues i dërgohet brenda 5 ditëve, sipas rastit, Gjykatës Kushtetuese ose Presidentit të Republikës.”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R E
Jozefina Topalli (Çoba)